



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 834 Prot.

Tiranë, më 29. 04. 2026

**V E N D I M**

**Nr. 110, datë 29. 04. 2026**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar<sup>2</sup>, shqyrtoi ankesën Nr. 244 regj, datë 22.10.2025, të paraqitur nga E. L., kundër Dekanes së Fakultetit të Ekonomisë, Shkodër, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të *gjendjes arsimore*<sup>3</sup> dhe *çdo shkak tjetër*<sup>4</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Bazuar në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, E. L., parashtron në ankesë se: “...në verën e vitit 2025, aplikova për pozicionin e pedagoges së jashtme në Fakultetin e Ekonomisë, Departamenti i Turizmit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni i Vlerësimit të Departamentit vendosi që unë të shpallesha fituese për këtë pozicion.

Gjatë zgjedhjeve për rektor, senat dhe drejtues në vitin 2024, unë isha caktuar si vëzhguese për llogari të një pedagogeje që ishte kundërshtarë e dekanes aktuale. Pas kësaj, duke qenë se unë kisha aplikuar për pozicionin e pedagoges së jashtme, dekania kërkoi anulimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Departamentit, ndonëse, sipas rregullores në fuqi, është komisioni i departamentit që vendos për fituesin. Roli i dekanes është vetëm mbikëqyrës dhe ajo vetëm përcjell vendimin të Rektori, i cili merr vendimin përfundimtar.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>3</sup> Nga ana e subjektit ankues nuk është analizuar se si ka ndikuar gjendja arsimore e saj në situatën diskriminuese të pretenduar.

<sup>4</sup> Ka referuar se shkak është bërë fakti që ajo ka qenë vëzhguese në zgjedhjet për organet drejtuese të Universitetit të Shkodrës, tek Fakulteti i Ekonomisë, i kandidatës e cila nuk është shpallur fituese për pozicionin e Dekanit të këtij fakulteti.

*Dua të theksoj se pa marrë asnjë njoftim zyrtar për anulimin e vendimit të mëparshëm, Universiteti ka hapur një thirrje të re për aplikime për pedagogë të jashtëm, duke anashkaluar procesin ekzistues dhe duke cenuar të drejtën time ligjore”.*

Në vijim, përmes e-mail-eve datë 23.10.2025, datë 24.10.2025 dhe datë 27.10.2025, ankuesja ka informuar Komisionerin ndër të tjera se: “...Në mënyrë informale kam marrë informacion se Komisioni Ad Hoc ka përfunduar vlerësimin e dosjeve në procedurën e parë më datë 14 tetor 2025 dhe i ka dërguar vendimin po atë ditë Dekanes. Sipas informacionit që kam marrë, kur Dekania ka konstatuar se unë jam fituese, ka thënë: “Këtë vendim do e shfuqizoj dhe nuk do e lejoj të marr pjesë” dhe ka kaluar disa ditë për të gjetur arsyetime për shfuqizimin e vendimit. Më datë 21 tetor 2025 (informacion i marrë në mënyrë informale) vendimi u shfuqizua me arsyetimin: “Për moszbatim të rregullores së punësimit”.

*Duke qenë se unë nuk kam marrë asnjë njoftim zyrtar, siç parashikon Rregullorja e Punësimit (neni 18, pika 4 dhe neni 21, pika 1 e 2), (sepse dekania e ka mbajtur peng vendimin) kam dërguar një email Dekanes për kërkesë informacioni dhe për dijeni të Rektorit dhe Drejtueses së Departamentit të Turizmit mbi statusin e aplikimit tim të parë, pasi procedura e dytë është hapur pa përfunduar e para.*

*Akoma sot nuk kam marrë asnjë informacion zyrtar mbi këtë çështje dhe as për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Ad Hoc, të cilin e kam mësuar vetëm në mënyrë informale.*

*Bazuar në nenin 18, pika 1 të rregullores së punësimit, dekania ka rol monitorues të procesit. Sipas nenit 19 të po kësaj rregulloreje, komisioni ad-hoc shqyrton dosjet dhe rendit fituesit... Sipas nenit 19 pika 2, vendimi i komisionit ad-hoc përcillet për miratim përfundimtar te rektori dhe sipas nenit 113 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror”, pra shfuqizimi prezumohet të ishte bërë nga rektori pasi vendimi i komisionit të ishte përcjellë te rektori nga dekania me komentet përkatëse të saj (meqë nuk ka qenë dakord).*

*Neni 21 i kësaj rregullore parashikon të drejtën e ankimit me afate përkatëse, mirëpo dekania e ka shkelur këtë nen pasi ka hapur procedurë të dytë, pa na informuar zyrtarisht për statusin e procedurës së parë dhe pa na dhënë afatet e parashikuara në këtë rregullore për ankimim, gjë që prezumohet që vendimi i shfuqizimit të procedurës së parë që është bërë 7 ditë pas hapjes së procedurës së dytë (info informale pasi zyrtarisht nuk kam njoftim), nuk ka vlerë ligjore dhe administrative.*

*Neni 15 i kësaj rregullore thotë që “Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën përkatëse, në sistemin me kohë të plotë”. Unë kam mbaruar Fakultetin Ekonomik, degën Administrim Biznes (të vetmen degë që ekzistonte në atë kohë në këtë fakultet), me korrespondencë para 20 e pak viteve, me program të njëjtë (8 semestra) me atë me kohë të plotë dhe para se të futej sistemi i Bolonjës si strukturë ciklesh studimi, që do të thotë që programi i studimit është i njëjtë dhe prezumohet që ka të njëjtën vlerë, dhe ciklin e dytë të studimeve në fushën përkatëse (Turizëm), me kohë të plotë.*

*Ndërsa në nenin 16 të po kësaj rregulloreje për dokumentet e konkurrimit thuhet të dorëzojë “diplomën dhe certifikatën e notave të studimeve në specialitetin ku është shpallur konkurs”, pra nënkuptohet diplomën e master i Turizmit që është specialiteti ku unë konkurroj. Pra, nuk specifikohen cili cikël i studimeve por vetëm studimet në specialitetin e konkursit që do të thotë që aplikimi im është*

*brenda kushteve. Kjo e sqaruar pasi ka qenë një nga komentet e dekanes që unë e kam marrë në mënyrë informale. Megjithatë, ka raste të tjera të ngjashme me rastin tim që dekania i ka miratuar dhe që unë do jua dërgoj në një email të dytë pas këtij. Në nenin 19 të kësaj rregulloreje thuhet “Komisioni ad-hoc vlerëson performancën akademike dhe profesionale të kandidatit.” Gjë të cilën jo vetëm komisioni por shumica e fakultetit është në dijeni...”*

Sakaq, E. L. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që në përfundim të shqyrtimit të ankesës, të konstatojë diskriminim e saj nga ana e Dekanes së Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Shkodrës, për shkak të gjendjes arsimore dhe faktit që ka qenë vëzhguese në zgjedhjet e realizuara gjatë vitit 2024 për drejtues në Universitetin e Shkodrës, për llogari të një pedagogeje që ishte kundërshtarë e dekanes aktuale<sup>5</sup>.

Gjithashtu, ka kërkuar ndër të tjera, të merren masa për:

- Pezullimin i procedurës së dytë sa i përket konkurrimit për pedagog të jashtëm në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Shkodrës.
- Anulimin e vendimit të dekanes për shfuqizimin e vendimit të Komisionit Ad Hoc të procedurës së parë, duke e konsideruar vendimin e shfuqizimit të dekanes si të paligjshëm, dhe lënien në fuqi e këtij vendimi të Komisionit Ad Hoc.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Në nenin 1 të LMD parashikohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”, ndërsa në nenin 12, “Ndalimi i diskriminimit”, pika 1, germa “b”, të po këtij ligji, parashikohet: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet

<sup>5</sup> Cituar nga ankuesja në formularin e ankesës.

në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ..... b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; ”

Bazuar në nenin 7, pika 1, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me anë të shkresës nr. 1471/1 prot., datë 30.10.2025, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Fakulteti i Ekonomisë të Universitetit të Shkodrës, sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje përsa më lart, Fakulteti i Ekonomik Shkodër, përmes shkresës<sup>6</sup> nr. 1388/1 prot., datë 10.11.2025, informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndër të tjera se: “...*Procedura e punësimit (vendimi i Komisionit AD-HOC i Departamentit të Turizmit) nuk ka marrë ende formë të prerë dhe për këtë arsye, po përcjell këto të dhëna si informacion paraprak, në mënyrë që ankuesja të ketë mundësi të ushtrojë të drejtën e saj ligjore për ankim brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e Punësimit.*

### **1. Rregullorja e re e punësimit e miratuar në vitin 2025.**

*Sipas Rregullores së Punësimit, e cila është miratuar në vitin 2025 (bëhet fjalë për një rregullore të re e cila është ndryshuar dy herë gjatë vitit 2025), punësimi i pedagogëve me kohë të pjesshme është i rregulluar në nenet 15-22.*

*Procedura e punësimit për pedagogë me kohë të pjesshme parashikon:*

- a. *Rinovim automatik për pedagogët që janë aktivizuar në vitet e mëparshme - pedagogët paraqesin kërkesë për riaktivizim dhe departamenti realizon një vlerësim performance (kjo kategori është e përjashtuar nga aplikimi online sipas nenit 17 pika 1 dhe nenit 48 pika 4).*
- b. *Pedagogët që nuk kanë qenë të aktivizuar më parë duhet të aplikojnë online në faqen zyrtare të USH sipas njoftimit përkatës - në këto raste kemi të bëjmë me aktivizime të reja.*

### **2. Hapja e thirrjes për pedagogët e jashtëm nga USH për të gjitha fakultetet.**

*Në muajin tetor është publikuar thirrja për punësim për pedagogë me kohë të pjesshme nga Rektorati i USH në faqen zyrtare. Kjo thirrje nuk është përcjellë me një njoftim të veçantë në fakultetin tonë!*

*Më datë 14.10.2025 në faqen zyrtare të USH është hapur përsëri thirrja për të gjitha fakultetet (nuk është realizuar me kërkesë të Fakultetit Ekonomik) dhe në këtë rast është dërguar njoftim zyrtar në email sipas shkresës bashkëngjitur, duke specifikuar që afati përfundimtar për dorëzimin*

<sup>6</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1479/2 prot., datë 11.11.2025.

e aplikimeve nga pedagogë me kohë të pjesshme për vitin akademik 2025-2026 do të jetë data 17.10.2025 (sipas pikës 2 të nenit 17). (<https://unishk.edu.al/njoftime/njoftime-per-punesim-pedagog-te-jashtem>).

Pas përfundimit të aplikimeve, IT dhe Burimet Njerëzore dërgojnë me email listën e aplikantëve (në formatin Excel) te dekani i fakultetit, i cili ka për detyrë ta përcjellë listën te shefat e departamenteve (Financë-Kontabilitet & Administrim Biznes & Turizëm) për vlerësim nga komisionet AD-HOC të secilit departament.

### **3. Tërheqja e dosjeve dhe procesi i vlerësimit nga shefja e departamentit.**

Më tej, është detyrë e shefit të departamentit të tërheqë dosjet pranë Burimeve Njerëzore dhe t'i mbajë ato në zyrën e tij deri në përfundim të procedurës.

Përzgjedhja e kandidatëve bëhet nga Komisioni AD-HOC i krijuar nga njësia bazë, ku titullar është shefi i departamentit dhe ky grup duhet miratuar nga dekani (neni 19 pika 2).

### **4. Dërgimi për miratim te Dekani.**

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit, shefi i departamentit dërgon njoftimin për riaktivizim për pedagogët të cilët kanë qenë të aktivizuar në vitin e kaluar ose për fitues të rinj, dhe ky vendim duhet të miratohet nga dekani dhe nga rektori. Bazuar në nenin 19 të Rregullores së Punësimit, këto dy hallka ushtrojnë kontrollin e ligjshmërisë mbi aktet e nxjerra nga komisionet AD-HOC.

### **5. Miratimi dhe dërgimi i njoftimit te pjesëmarrësit në konkurs - e drejta e ankimimit.**

Vetëm pas miratimit përfundimtar, shefi i departamentit realizon njoftimin për pjesëmarrësit në konkurs (pranim/mospranim), dhe konkurruesit të cilët nuk janë shpallur fitues kanë të drejtën të paraqesin ankesë brenda 2 ditëve nga marrja e njoftimit (neni 21). Brenda 5 ditëve, dekani shqyrton ankimimet e secilit kandidat dhe del me vendim i cili duhet të jetë i arsyetuar dhe është i formës së prerë. Vetëm pas përfundimit të procesit të ankimimit, procedohet me lidhjen e aktmarrëveshjeve dhe firmosjen e kontratave.

### **6. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët me kohë të pjesshme**

Kandidatët për pedagogë me kohë të pjesshme duhet të plotësojnë kriteret për punësim që janë të përcaktuara në nenin 5 të Rregullores:

...

2. Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushat përkatëse.

3. **Nota mesatare e përgjithshme duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 në ciklin Bachelor dhe 8.5 Master.** Në rastet e diplomave me program studimi 4-vjeçar, mesatarja duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (para hyrjes në fuqi të Bolonjës).

4. **Nota mesatare e grup lëndëve duhet të jetë jo më e ulët se 9.**

5. **Nota mesatare mbi 8.5 për programet që kanë zgjatur të paktën 4 vite ose 8 semestra.**

6. Kandidati duhet të ketë mbaruar doktoraturën ose shkollë universitare studimesh të thelluara.

7. Studenti duhet të ketë dhënë domosdoshmërisht lëndën që kërkon të japë.

8. Të njohë një gjuhë të huaj.

9. Kriteri i doktoraturës nuk është përjashtues për pedagogët me kohë të pjesshme (neni 15 pika 8).

10. Nëse departamenti kërkon të shpallë fitues kandidat me mesatare me të ulët se ajo zyrtare, për shkaqe të ligjshme (mungesë të aplikantëve që plotësojnë kriterin ligjor 8.5), duhet të bëjë kërkesë të veçantë dhe, sipas nenit 15 pika 9, këto kritere detyrimisht duhet të miratohen nga dekani dhe nga rektori i USH dhe të bëhen të njohura në momentin e njoftimit të vendit vakant (në njoftimin për punësim që publikohet në faqen zyrtare).

### **7. Rastet kur nuk ka aplikantë që plotësojnë kriteret - Kërkesë për uljen e mesatares.**

Kërkesa për ulje të mesatares realizohet pasi dështon thirrja e parë për mosplotësim të kandidateve me kushtet e përcaktuara në nenin 15.

Në këtë rast është detyrim ligjor i grupit AD-HOC/Dekanit/Rektorit që të zbatojnë kriteret detyruese të përcaktuara në nenin 15 për shpalljen e fituesve dhe vetëm nëse nuk ka kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në rregullore (lëndët mbeten vakante), mund të propozojnë kritere më të ulëta në mënyrë që të miratohen nga dekani dhe rektori.

Në rastin e aplikimeve për pedagogë të jashtëm për vitin akademik 2025-2026, për shkak se hapja e aplikimeve nuk është realizuar me kërkesë të fakultetit, nuk kemi pasur asnjë kriter të ulët të miratuar nga dekani dhe rektori.

### **8. Kriteri i kualifikimit të ciklit pasardhës.**

Për shpërndarjen e ngarkesës mësimore është detyruese që të zbatohet kriteri i kualifikimit të ciklit pasardhës të diplomimit, sipas të cilit kandidati duhet të ketë të paktën kualifikimin e ciklit pasardhës (neni 40 pika 5 i Statutit dhe neni 59 i ligjit nr. 80/2015):

- ✓ Nëse kandidati për pedagog ka master shkencor, ai mund të aktivizohet vetëm në programet e Bachelor-it;
- ✓ Nëse kandidati ka doktoraturë, mund të aktivizohet edhe në ciklin e Masterit.

### **9. Roli i dekanit në procesin e punësimit**

Roli i dekanit në procesin e punësimit është përcaktuar qartë në procesin e punësimit të pedagogëve me kohë të pjesshme janë të bazuara në nenin 32, pika 6, shkronjat “l” dhe “i”, si dhe pika 11 të Statutit të USH, sipas të cilave:

- ✓ Drejton dhe kontrollon konkurset e pranimit të punonjësve akademikë dhe joakademikë në fakultetin e tij (pika “l”).
- ✓ Dekani ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e përgjegjës të departamentit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH-së dhe me vendimet e Senatit e të dekanatit (bazuar në nenin 32 pika “i” të Statutit).

Në përfundim, deklaroj se:

1. Konkursi nuk është anuluar, siç deklaroi studentja, por vendimi fillestar i Komisionit AD-HOC (Aneks 1 & Aneks 2) nuk është miratuar nga dekani për shkak të shkeljeve të Rregullores së

- Punësimi dhe është rikthyer për rishqyrtim nga Komisioni AD-HOC (Aneks 3). Vetëm në rastin e miratimit nga dekani dhe nga rektori do të procedohej me njoftimin përfundimtar të studentët.*
- Shkeljet që janë konstatuar nga dekani kanë qenë për të gjithë aplikantët dhe nuk kanë qenë selektive (vetëm për studenten ankuese). Kriteri që kandidatët nuk kanë plotësuar është ai i mesatares së Bachelor-it (duhet mbi 8.5, sipas nenit 15 pika 2, 3 dhe 4). Për këtë arsye vendimi është kthyer për rishqyrtim te Komisioni AD-HOC, së bashku me urdhrin për zbatimin e Rregullores së Punësimi (Aneks 2: Tabelë vlerësimi e vendimit nr. 46, datë 15.10.2025, nr. protokolli 1259).*
  - Ndërkohë që Komisioni AD-HOC i Departamentit të Turizmit është mbledhur për të vlerësuar kandidatët paraprakë më datë 15.10.2025, sistemi i aplikimit ka qenë i hapur nga universiteti (më datë 14.10.2025) dhe ka pasur edhe aplikantë të rinj që kanë sjellë dosjen për vlerësim dhe këto dosje janë tërhequr nga shefja e departamentit dhe janë vlerësuar nga Komisioni AD-HOC (Aneks 9: Email i IT drejtuar të gjithë dekanëve me datë 14.10.2025).*
  - Në përfundim të procedurës, Komisioni AD-HOC i Departamentit të Turizmit ka dërguar vendimin e ri, i cili është miratuar nga dekani dhe është përcjellë për miratim të rektori me datë 05.11.2025 (Aneks 4 & Aneks 5 & Aneks 6 & Aneks 7 & Aneks 8).*
  - Vetëm pasi përfundon kjo procedurë, shefi i departamentit (kryetar i komisionit) realizon njoftimin e kandidatëve me email (sipas pikës 3 të nenit 19), të cilët kanë të drejtë të paraqesin ankesë sipas nenit 21 të Rregullores së Punësimi (edhe ndaj vendimit të shfuqizimit) (Aneks 10).*

*Për sa i përket veprimeve që unë kam ndërmarrë si dekanë, ato janë në përputhje të plotë me Rregulloren e Punësimi, Statutin e USH, ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë” dhe Kodin e Procedurës Administrative.*

*Fakulteti ka të drejtën e propozimit të kriterëve lehtësuese vetëm në rastet kur nuk ka kandidatë të tjerë që i plotësojnë kriteret dhe konkursi dështon. Këto kriterë duhet të miratohen edhe nga rektori dhe të jenë të shpallura në momentin e hapjes së thirrjes nga USH.*

*Në vijim po dërgoj këtë informacion për ankesën e E. L., pasi shpallja e rezultatit të konkursit të punësimi është realizuar ditën e hënë, më datë 03.11.2025, dhe jemi ende në fazën e ankimit administrativ, sipas nenit 21 të Rregullores së Punësimi.”.*

- Sakaq, Komisioneri përmes e-mail-it datë 11.11.2025, i përcolli ankueses një kopje të shkresës së Fakultetit Ekonomik Shkodër, nr. 1388/1 prot., datë 10.11.2025, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe kërkoi parashtrime me shkrim nga ana e saj.*

*Në këtë kuadër, më datë 12.11.2025, përmes e-mail-it, ankuesja depozitoi parashtrimet e saj sa i përket përgjigjes së vënë në dispozicion nga ana e Fakultetit Ekonomik Shkodër duke sqaruar ndër të tjera se: “...**I. Rregullorja e Re e Punësimi e Miratuar në Vitin 2025***

*Dekania nuk citon saktë nenin 17 të Rregullores së punësimi të UNISHK duke u shprehur “Rinovimi automatik për pedagogët e jashtëm që janë aktivizuar në vitet e mëparshme, pedagogët paraqesin kërkesë për aktivizim dhe departamenti realizon një vlerësim performance ndërsa në rregulloren e punësimi”.*

Ndërsa neni 17 i rregullores së punësimit të UNISHK, thotë: “Aplikimi i personelit akademik me kohë të pjesshme 1. Procesi i punësimit i personelit akademik me kohë pjesshme në USH realizohet përmes aplikimit on-line në faqen zyrtare të USH-së, pas shpalljes së vendit të lirë nga strukturat përgjegjëse. Përfshihet nga aplikimi online personeli akademik me kohë të pjesshme i angazhuar vitet e mëparshme dhe që kërkon me shkrim vazhdimin e angazhimit në mësimdhënie pasi departamenti ka bërë vlerësimin pozitiv të performancës”.

Dekania sugjeron një rinovim automatik për pedagogët që kanë qenë të angazhuar më parë dhe kërkojnë riaktivizimin, duke thënë se ata duhet të paraqesin një kërkesë për aktivizim dhe, pas kësaj, departamenti do të bëjë një vlerësim të performancës.

Ndërsa neni 17 i rregullores përcakton një proces të ndryshëm: përfshihet nga aplikimi online është i mundur vetëm për personelin që ka qenë i angazhuar vitet e mëparshme dhe kërkon vazhdimin e angazhimit, por **vlerësimi pozitiv i performancës bëhet përpara paraqitjes së kërkesës për vazhdimin e angazhimit**. Ky përfshihet nga aplikimi online nuk nënkupton një rinovim automatik, por një procedurë formale ku pedagogët duhet të paraqesin kërkesën për rinovim, dhe vetëm pas vlerësimit pozitiv të performancës nga departamenti.

## **2. Hapja e thirrjes për pedagogët e jashtëm nga USH për të gjitha fakultetet.**

Dekania shkruan që në muajin tetor (por nuk citon në cilën datë) është publikuar thirrja për punësim për pedagogë me kohë të pjesshme nga Rektorati i USH në faqen zyrtare dhe se kjo thirrje nuk është përcjellë me një njoftim të veçantë në Fakultetin Ekonomik. Më pas shkruan që me datë 14.10.2025 në faqen zyrtare të USH është hapur sërish thirrja..., Dekania është shumë kontradiktore në informacionet e saj pasi shkruan që në muajin tetor qenkan hapur dy thirrje për punësim për pedagogë me kohë të pjesshme dhe ky është një informacion zyrtar i dërguar nga dekania dhe i firmosur prej saj dhe mban përgjegjësi ligjore për çdo informacion që jep.

Thirrja e parë është publikuar në shtator 2025 dhe në të cilën unë kam aplikuar më datë 26 shtator 2025.

Nëse as ky njoftim nuk është përcjell në Fakultetin Ekonomik, si e shpjegon dekania që është realizuar procedura e vlerësimit të dosjeve në departamentin e turizmit dhe në departamentin e Financës (për këto të dyja që di unë por mund të jetë zhvilluar dhe të departamenti tjetër) për këtë procedurë (mund të kërkohej dokumentacioni për verifikim)? Si i morën emrat e aplikantëve dhe dosjet e tyre përkatëse komisionet ad-hoc të aplikuesve në këtë procedurë? Pasi në nenin 17 pika 4. Aplikanti i cili nuk ka aplikuar on-line dhe nuk ka dorëzuar dosjen me dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të përcaktuara në njoftimin zyrtar nuk mund të konkurrojë për vendin e shpallur të punës.

Kjo gjë të bën të mendosh që ose dekania fsheh faktin që emrat e aplikantëve të kësaj procedure janë kaluar në komisionet ad hoc të departamenteve të fakultetit ekonomik nga ajo ose kjo gjë është bërë pa dijeninë e saj e kjo të bën të mendosh që nuk ka realizuar detyrat e përgjegjësitë e saj.

Nisur nga këto dhe shumë të tjera, në ankesën time të datës 4.11.2025, kam kërkuar “**Kopje të gjithë korrespondencës zyrtare që lidhet me procedurën e parë, përfshirë emailt/nota/udhëzime dhe datat kur vendimi i Komisionit është përcjellë te Dekani dhe më pas te Rektori, pasi mendoj që ka korrespondenca mes dekanes e komisionit ad-hoc të cilat dekania nuk i vë në dispozicion**”.

*Dekania shkruan që më datë 14.10.2025 është hapur përsëri thirrja (pra nuk mohohet që ka qenë më përpara një thirrje tjetër) për të gjitha fakultetet dhe nuk është realizuar me kërkesë të Fakultetit Ekonomik dhe që është dërguar njoftim zyrtar me email sipas shkresës së bashkëlidhur duke specifikuar afatin sipas pikës 2, neni 17.*

*Në përputhje me Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, neni 32, pika “l”, si dhe me nenin 18 të Rregullores së Punësimit, Dekania ka detyrimin ligjor për të ushtruar funksionin e drejtimit, kontrollit dhe monitorimit të plotë mbi procedurat e konkurseve për pranimin e punonjësve akademikë dhe joakademikë në fakultetin përkatës. Kjo do të thotë se Dekania është përgjegjëse drejtpërdrejt për të siguruar që çdo procedurë të zhvillohet, monitorohet dhe mbyllet në mënyrë të ligjshme dhe transparente, dhe nuk mund ta zhvendosë përgjegjësinë tek Rektorati apo ndonjë strukturë tjetër.*

*Në këtë kontekst, hedhja e fajit tek Rektorati për hapjen e procedurës së dytë, ndërkohë që e para nuk është përfunduar, përbën një shmangie të përgjegjësisë ligjore dhe institucionale të Dekanes, sepse neni 18 përcakton qartë se përzgjedhja bëhet nga njësia bazë, por monitorohet nga drejtuesi i njësisë kryesore, pra, nga Dekania. Ky detyrim përfshin mbikëqyrjen e procesit nga fillimi deri në përfundim dhe sigurimin që një procedurë e re nuk hapet pa u mbyllur dhe pa u bërë njoftimi zyrtar për procedurën ekzistuese.*

*Prandaj, nëse procedura e dytë është hapur pa përfunduar e para dhe pa njoftuar kandidatët për statusin e aplikimeve të tyre, Dekania nuk e ka zbatuar në mënyrë të plotë dhe efektive funksionin e saj ligjor të drejtimit dhe kontrollit mbi konkurrimet, siç përcaktohet në Statut dhe në Rregullore. Ky veprim përbën shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 32 të Statutit dhe në nenin 18 të Rregullores së Punësimit, dhe nuk mund të justifikohet me vendimmarrjen e Rektoratit, pasi kompetenca për mbikëqyrjen e procesit i takon ekskluzivisht Dekanit si drejtues i njësisë kryesore.*

*Ajo vetë e pranon që hapja e procedurës së dytë është bërë pa kërkesën e Fakultetit Ekonomik. Çfarë do të thotë kjo? Që dekania nuk ka dijeni për asgjë çfarë ndodh apo që dekania pranon procedurën e parë dhe është në kundërshtim me çfarë shkruan më sipër që thirrja e parë nuk është përcjell me njoftim të veçantë në fakultetin e tyre.*

*Gjithashtu dekania citon njoftimin zyrtar sipas shkresës bashkëngjitur (emaili nga IT, Aneksi 9 i kthimit të përgjigjes) por që shkresa a emaili bashkëngjitur nuk ka datë se kur është nisur përveçse datën e përfundimit të aplikimeve dhe datën e printimit të emailit që është 7.11.25. Pra nuk vërtetohet që aplikimi është hapur më datë 14.10.25 siç shkruan dekania. Aplikimi i dytë është hapur më datën 15.10.2025 dhe përfundonte me datë 17.11.2025 (IT besoj mund të ketë dokumentacion vërtetues pasi duhet ta ketë hapur aplikimin online sipas një dokumenti zyrtar).*

*Më pas dekania shkruan që “Pas përfundimit të aplikimeve, IT, dhe burimet njerëzore dërgojnë me email listën e aplikantëve te dekani i fakultetit që i përcjell te shefat e departamenteve për vlerësimin nga komisionet ad-hoc”. Si shpjegohet që dekania thotë që thirrja e parë nuk është përcjellë në Fakultetin Ekonomik ndërkohë që ekziston një vendim i komisionit ad-hoc të Departamentit të Turizmit më datë 14.10.25 për përfundimin e procesit të vlerësimit të dosjeve të aplikantëve të procedurës se parë??? Thua ky proces përcjellje i listës se emrave të aplikantëve nga IT, Burimet njerëzore me email te dekania dhe kjo e fundit te shefat e departamenteve është imagjinatë apo mbase fakt i harruar nga dekania. Prandaj dhe njëherë*

theksoj që kërkoj komunikimin me email të dekanes me komisionin ad-hoc pasi lista e emrave të procedurës se parë janë përcjellë nga dekania te komisioni ad – hoc dhe dekania nuk mund të injorojë procedurën e parë.

Dyshoj që nuk është miratuar asnjë vendim i komisioneve Ad-Hoc në procedurën e parë e prandaj kam kërkuar dokumentacionin zyrtar për 2 procedurat e aplikimit për pedagogë të jashtëm për vitin akademik 2025-2026 (për të dy procedurat) për të tre departamentet e FE.

#### **4. Dërgimi për miratim te dekani.**

Dekania përsëri citon gabim nenet e rregullores së punësimit pasi neni 19 i kësaj rregulloreje nuk thotë siç citon dekania që **“Pas përfundimit të procesit të vlerësimit shefi i departamentit dërgon njoftim për riaktivizim për pedagogët që kanë qenë të aktivizuar në vitin e kaluar ose për fituesit e rinj dhe ky vendim duhet të miratohet te dekani dhe rektori”**, por neni 19 i rregullores së punësimit me të gjitha pikat e këtij është si më poshtë: **“Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve: 1. Dosjet shqyrtohen nga komisioni ad-hoc. Komisioni rendit fituesit sipas radhës zbritëse, duke filluar nga konkurrenti që rezulton me pikë më të larta, deri tek ai që ka pikët më të ulëta. Komisioni verifikon të dhënat e aplikantëve dhe skualifikon aplikantët që kanë deklaruar të dhëna jo të vërteta. 2. Renditja bazohet te sistemi i pikëzimit të detajuar në këtë rregullore. Komisioni ad-hoc vlerëson performancën akademike dhe profesionale të kandidatit. Pas renditjes së konkurrentëve, komisioni ad-hoc harton vendimin me fituesit dhe e përcjell për miratim paraprak te dekani përkatës, i cili e përcjell te Rektori për miratim përfundimtar. 3. Konkurrentët njoftohen nga kryetari i komisionit ad-hoc. 4. Lista e kandidatëve fitues për pedagogë me kohë të pjesshme me gjeneralitetet përkatëse emër/mbiemër, shpallet në faqen zyrtare të USH-së, sipas afateve të përcaktuara nga komisioni.**

Pra nuk përmendet riaktivizim i pedagogëve që kanë qenë vitin e kaluar (që mbase dekania ka patur plane të tjera) por renditja e fituesve që bazohet në pikëzimin e rregullores dhe te performanca akademike e profesionale, ku në vendimin e komisionit ad-hoc unë kam dal fituese. Nëse do flitet me kaq respektim të rregullores se punësimit të UNISHK, si ka mundësi që Dekania këtë vit ka vënë veten në komisionin ad hoc për vlerësimin e përzgjedhjen e pedagogëve të jashtëm në departamentin e Financës së Fakultetit Ekonomik dhe e ka miratuar si dekane, vendimin e këtij komisioni ad hoc ku ajo ka futur veten, dmth ka miratuar vendimin që ka nxjerr ajo vetë. Nëse do flitej për moszbatim të rregulloreve, dekania është e para që nuk i zbaton. Prandaj do kërkoja të viheshin në dispozicion komisionet e miratuara Ad-Hoc të 3 departamenteve të Fakultetit Ekonomik për dy vitet e fundit.

#### **5. Miratimi dhe dërgimi i njoftimit te pjesëmarrësit në konkurs - e drejta e ankimimit.**

Dekania sërish citon rregulloren e punësimit të UNISHK gabim pasi shprehet që **“Vetëm pas miratimit përfundimtar, shefi i departamentit realizon njoftimin për konkurrentët që nuk janë shpallur fitues të cilët kanë të drejtën e ankimimit..”**

Sipas nenit 19 pika 2 e 3 si dhe nenit 22 të rregullores së punësimit të UNISHK, theksohet se procedura e ankimimit realizohet para miratimit përfundimtar të vendimit nga Rektori, e jo pas tij siç ka përmendur dekania.

### ***Neni 19: Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve***

*Pas renditjes së konkurrentëve, komisioni ad-hoc harton vendimin me fituesit dhe e përcjell për miratim paraprak te dekani përkatës, i cili e përcjell te Rektori për miratim përfundimtar. Konkurrentët njoftohen nga kryetari i komisionit ad-hoc.*

### ***Neni 22: Akt-marrëveshja***

*Pas procesit të ankimimit përgjegjësi i njësisë bazë/departamentit lidh akt-marrëveshjen për ngarkesën mësimore dhe afatin e punësimit. Akt-marrëveshja miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekanit. Akt-marrëveshja duhet shoqëruar me dokumentet e kërkuara në njoftimin përkatës. Dosjet e kandidatëve fitues së bashku me akt-marrëveshjen dërgohen nga drejtuesi i njësisë bazë pranë Sektorit të Burimeve njerëzore të USH-së, së bashku me një kopje të vendimit të komisionit të miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani. **Një kopje e vendimit të komisionit të miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani dërgohet edhe te Rektori.***

*Pra jo siç citon dekania që vetëm pas miratimit përfundimtar (që sipas rregullores bëhet nga rektori) realizohet njoftimi i pjesëmarrësve që nuk kanë fituar e më pas realizohet procedura e ankimimit. Procedura e ankimimit realizohet para miratimit përfundimtar se përndryshe nuk ka vlerë.*

*Megjithatë nuk është rast i izoluar që dekania vepron në mosrespektim të urdhrave të rektorit pasi ekziston një urdhër i rektorit që stafi administrativ i fakultetit, nuk lejohet të jap mësim vetëm në rastet kur ka mbaruar vitin e parë të doktoraturës, dhe dekania ka miratuar si pedagogë të jashtëm në Departamentin e Financës, 2 kandidatura që janë pjesë e stafit administrativ dhe akoma nuk kanë filluar vitin e parë të doktoraturës, duke shkelur urdhrin e miratuar të rektorit. Këto mund të vërtetohen në verifikimin e procedurave të punësimit të dy viteve të fundit (gjithmonë nëse dekania nuk do fshihte dokumente e do i vinte në dispozicion të gjitha).*

### ***7. Rastet kur nuk ka aplikantë që plotësojnë kriteret - kërkesë për uljen e mesatares***

*Pika 10 e kriterëve që duhet të plotësojnë kandidatët me kohë të pjesshme thuhet që nëse departamenti kërkon të shpallë fitues kandidatë me mesatare më të ulët se ajo zyrtare etj etj, duhet të bëjë shkresë të veçantë etj etj. Në dijeninë time ekziston një Vendim a Shkresë e tillë nga komisioni ad-hoc i Departamentit të Turizmit që nëse nuk ka aplikantë me mesatare 8.5 të bachelor-it, mesatarja ulet dhe fakti është që asnjë nga aplikantët në procedurën e parë nuk e kanë patur mesataren 8.5 të bachelorit dhe të gjithë janë vlerësuar me 0 pikë për këtë kriter. (Aneksi 2 i kthimit të përgjigjes së dekanes). Brenda mundësive të kërkohet ky vendim a shkresë pasi ekziston. Duhet theksuar që çdo vit është proceduar kështu dhe mund të kërkohen procedurat e 2 viteve të fundit (2024-2025 dhe 2025-2026 të të dy procedurave) së bashku me dosjet e fituesve për pedagogë të jashtëm dhe të verifikohen vendimet a shkresat e tilla pasi ka patur çdo vit të tilla dhe dekania është mirë në dijeni.*

*Dekania citon sërish gabim rregulloren e punësimit të UNISHK, pasi shprehet “**Kërkesa për ulje të mesatares realizohet pasi dështon thirrja e parë për mosplotësimin e kandidatëve me kushtet e përcaktuara në nenin 15**”.*

*Ndërsa Neni 15, pika 7 thotë që “...mund të vendosin kritere të veçanta dhe kufij më të lartë apo më të ulët në varësi të specifikës së tyre, rast pas rasti...”.*

*Komisioni Ad-Hoc e ka bërë një vendim të tillë për procedurën e parë (pra nuk citohet në rregulloren e punësimit **Pasi dështon thirrja e parë**, siç citon gabim Dekania) dhe e ka njoftuar ose dorëzuar dekanes (duhet kërkuar vënia në dispozicion e këtij dokumenti).*

*Dekania sërish injoron procedurën e parë duke thënë që “**Në rastin e aplikimeve për pedagogë të jashtëm për vitin akademik 2025-2026, për shkak se hapja e aplikimeve nuk është bërë me kërkesë të fakultetit, nuk ka asnjë kriter të miratuar nga dekani a rektori**”. Akoma dekania nuk pranon faktin që bëhet fjalë për 2 procedura dhe që komisioni ad-hoc ka dërguar te dekania një vendim a shkresë si më sipër citova dhe dekania është mirë në dijeni dhe është respektuar e njëjta procedurë si çdo vit (pasi ka ndodhur njësoj dhe vitin e kaluar dhe dekani është shumë mirë në dijeni), prandaj kam kërkuar procedurën e dy viteve të fundit dhe këtu verifikohen që këto vendime a shkresa janë të njëjta si vitin e kaluar ashtu dhe këtë vit pavarësisht që dekania vitin e kaluar i pranon e këtë vit jo. Nëse dekania nuk e ka dërguar për miratim te rektori, përgjegjësia bie mbi të. Procedurat e rregullat janë zbatuar identik si dhe vitin e kaluar për të tre departamentet e fakultetit ekonomik.*

#### **8. Roli i dekanit në procesin e punësimit**

*Përsëri dekania keqinterpreton ligjin, pasi neni 32, pika “i” të Statutit thuhet që “Dekani ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e përgjegjës të departamentit në rastet kur ato bien ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.”*

*Pra, dekani ka një detyrim ligjor për të monitoruar dhe mbikëqyrur procedurat e përzgjedhjes dhe për të siguruar që ato të përfundojnë përpara se të hapen procedura të tjera.*

*Ky nen nuk gjen zbatim në rastin konkret, dhe përdorimi i tij si bazë arsyetimi është juridikisht i pasaktë dhe jashtë kontekstit të procedurës që po shqyrtohet pasi subjekti i vendimmarrjes nuk është përgjegjësi i departamentit, por Komisioni Ad-Hoc.*

*Sipas nenit 19 të Rregullores së Punësimit, përzgjedhja dhe vlerësimi i kandidatëve për pozitën e personelit akademik me kohë të pjesshme kryhet nga Komisioni Ad-Hoc, i cili është një organ kolegjal me kompetencë të përcaktuar, dhe jo një organ drejtues departamenti. Ky komision, pas përfundimit të vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve, harton vendimin për fituesit.*

*Kështu, në këtë proces përgjegjësi i departamentit nuk ushtron asnjë kompetencë vendimmarrëse, përveçse në cilësinë e mundshme të kryetarit të komisionit ad hoc, që është një rol teknik e kolegjal, jo administrativ i pavarur.*

*Neni 32, pika “i” i Statutit nuk përfshin dhe nuk mund të zgjerohet për të mbuluar vendimet e komisioneve kolegjiale. Ky nen ka të bëjë vetëm me vendime administrative individuale të marra nga përgjegjësi i departamentit në ushtrimin e funksioneve të tij si drejtues i njësisë bazë. Në asnjë rast ky nen nuk i jep Dekanit kompetencë të shfuqizojë vendime të një organi kolegjal si Komisioni Ad-Hoc, i cili vepron në bazë të Rregullores së Punësimit dhe në kuadër të një procedure të përcaktuar me afate, kritere dhe dokumentacion zyrtar. Çdo ndërhyrje e Dekanit në një vendim të tillë, jashtë kompetencës ligjore, përbën tejkalim të kompetencave administrative dhe shkelje të parimit të ligjshmërisë, të parashikuar në Ligjin nr. 44/2015 “Për Procedurat Administrative”.*

Interpretimi që Dekani mund të shfuqizojë vendime të Komisionit Ad-Hoc cenon autonominë e procesit të përzgjedhjes, do të anulonte rolin e komisioneve të pavarura dhe do të krijonte precedent të rrezikshëm për ndërhyrje subjektive. Duke qenë se bëhet fjalë për vendim të Komisionit Ad-Hoc, e jo për vendim të përgjegjës të departamentit, neni 32, pika “i” nuk është i aplikueshëm në këtë situatë. Çdo përpjekje për të justifikuar ndërhyrje apo mosveprim në procesin e parë të konkurrimit, duke u mbështetur në këtë nen, është juridikisht e pabazë dhe administrativisht e gabuar, sepse nuk ekziston asnjë akt ligjor që i jep Dekanit të drejtën të shfuqizojë vendime të një organi kolegjal me mandat të përcaktuar.

### **Përsa i përket pikave të deklarimit të dekanes në përfundim:**

#### **Pika 1:**

Unë nuk kam thënë “**anulluar**”, por “shfuqizuar” dhe Dekania sërish është e pasaktë. Unë nuk jam “**Studente**” siç shprehet dekania por jam kandidatë për pozicion pune Pedagog i Jashtëm, jam një grua 51 vjeçe me një bagazh intelektual e profesional të lartë, me 2 fakultete të sistemit 4 vjeçar me MSC me 9 artikuj në konferenca shkencore ndërkombëtare (pavarësisht se në dosje kam depozituar 6 nga presioni që nuk do arrij në kohë afatin e aplikimit), kam qenë session chair në konferencë shkencore ndërkombëtare në Universitetin e Vjenës, jam arsimtare me eksperiencë pune në shkollë të mesme profesionale Hoteleri Turizëm pothuajse 26 vjeçare ku ka vite që jam nëndrejtoreshë, e certifikuar për drejtimin e Institucioneve të Arsimit Parauniversitar nga CSL (Fondacionit Shqiptaro -Amerikan për Zhvillimi (AADF) dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë), administratore në një NGO duke implementuar disa projekte, me shumë trajnime e shumë certifikime profesionale në dosjen profesionale. Unë nuk jam “**Studente ankuese**”, por kandidat ankues.

Vendimi i komisionit ad-hoc nuk është **vendim fillestar** (siç citon sërish gabim Dekania) por është vendim i fituesve pas procesit të vlerësimit të dosjeve i cili është kompetencë e këtij komisioni sipas nenit 18 e 19 të rregullores së punësimit të UNISHK. Në Urdhërin nr. 9 të datës 21.10.2025 “Për shfuqizimin e departamentit të Turizmit nr. 46, datë 14.10.2025 “Për përzgjedhjen e Stafit Akademik me kohë të pjesshme” shkruhet vetëm shfuqizim i vendimit të komisionit Ad-Hoc për mosrespektim të rregullores së punësimit dhe jo siç citon përsëri gabim Dekania “**dhe është rikthyer për shqyrtim nga komisioni Ad-Hoc.**”. Për të verifikuar të gjitha këto, kam kërkuar komunikimet zyrtare me email ndërmjet dekanes dhe komisionit Ad-Hoc dhe arsyeën ku nuk është respektuar rregullorja e punësimit dhe pse unë si një nga kandidatet nuk jam njoftuar për të gjithë këtë procedurë duke mu shkelur të drejtat e mia të informimit, duke cenuar rëndë transparencën në një institucion publik, dhe duke shkelur bazën ligjore të rregullores së punësimit dhe duke mos patur koherencë në informacionin zyrtar që jep. Fakti që më datë 14.10.2025 komisioni AD-HOC bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve të procedurës së parë, nxjerr vendimin i cili protokollohet më datë 15.10.2025 pasi dekania thotë që është hapur aplikim i dytë më datë 14.10.2025 që thotë që ka njoftim zyrtar (po që unë e dyshoj) dhe sipas dekanes nuk e ka miratuar dhe e ka kthyer në departament për rishqyrtim më datë 21.10.2025 (7 ditë pas hapjes së procedurës së parë), tregon për abuzim nga ana e dekanes. Kjo është në shkelje të plotë ligjore si dhe ka një informacion zyrtar jo të saktë pasi procedura e dytë është hapur më datë 15.10.2025 dhe duhej të ishte mbyllur

procedura e parë para kësaj date dhe duhej të ishin njoftuar kandidatët pasi ka patur një vendim komisioni Ad-Hoc dhe duhej të lihej dhe koha për ankimimin, ndërsa dekania shfuqizon vendimin e komisionit Ad-Hoc 7 ditë pasi hapet procedura e dytë dhe akoma nuk janë njoftuar kandidatët e procedurës së parë meqë procesi i vlerësimit të dosjeve është finalizuar me një vendim komisioni, gjë që dmth procedura e parë akoma është e hapur pasi nuk ka një vendim për përfundimin e saj akoma dhe është realizuar e përfunduar procedura e dytë pa mbaruar e para.

Dhe njëherë, dekania është komplet në shkelje të Rregullores së punësimit të UNISHK dhe Ligjit të Procedurave Administrative pasi në fillim nuk pranon që ka procedurë të parë pasi nuk i ka ardhur njoftim zyrtar, më pas pranon që është në dijeni për procedurën e parë sepse nuk ka kërkuar hapje të aplikimeve për herën e dytë dhe nuk ka qenë në dijeni. Më pas ripohon që është zhvilluar procedurën e parë pasi shpjegon në detaje ecurinë e procedurës së parë dhe më habit fakti që si është realizuar kjo procedurë pa i ardhur asaj në fakultet njoftim zyrtar dhe pa përcjellë ajo listën e emrave të aplikantëve të procedurës së parë të departamenti?

Dekania shprehet që vendimin e komisionit Ad-Hoc që është i datës 14.10.2025, nuk e ka miratuar dhe e ka rikthyer për rishqyrtim nga komisioni Ad-Hoc më datë 21.10.2025 (Aneksi 3 i kthimit të përgjigjes së dekanes), dmth 1 javë pasi ishte hapur procedura e dytë. Si i ka kërkuar rishqyrtim të vendimit të procedurës së parë, në një kohë kur ka filluar procedurën e dytë? Dmth Dekania pranon që ka vendim të procedurës së parë dhe është komplet në shkelje të rëndë procedurale e ligjore për zhvillim procedure mbi procedurë (pasi këtu pranon që nuk ka përfunduar procedurën e parë para fillimit të procedurës së dytë) në kundërshtim me rregulloren e punësimit të UNISHK. Gjithashtu ka shkelur rregullat baze të të drejtës së informimit, të drejtën time për ankimim, të drejtën time për tu dëgjuar, parime të ligjit për procedurat administrative duke abuzuar kështu me pozicionin e punës.

### **Pika 2:**

**Dekania shprehet që shkeljet e konstatuara kanë qenë për të gjithë aplikantët dhe nuk kanë qenë selektive...**

Dekania ka shfuqizuar me një vendim (që për sa unë kam lexuar Ligjin për procedurat administrative duhet të jetë jo ligjor) vendimin e komisionit ad hoc të procedurës së parë ku ishin 3 fitues por 2 nga këto, përveç meje kanë qenë pedagoge të jashtme vitin e kaluar (2024-2025) në Departamentin e Turizmit të Fakultetit Ekonomik me një vendim të miratuar nga kjo dekane dhe me një rregullore punësimi me të njëjtat kushte pavarësisht që sipas dekanes nuk kanë plotësuar kriterin e mesatares se bachelorit. Si ka mundësi që vitin e kaluar i ka miratuar edhe pse mesataren e bachelorit e kanë patur më të ulët se 8.5 dhe sot shfuqizon vendimin? Kjo tregon dhe njëherë që dekania ka 2 standarde në trajtimin e rasteve dhe që dekania e ka bërë për të më anuluar pikërisht vendimin për mua duke me diskriminuar dhe ka qenë selektive. Prandaj kërkoj verifikimin e procedurave të dy viteve të fundit për të tre departamentet, procedura që janë monitoruar e kontrolluar nga kjo dekane me të njëjtat kushte punësimi. Aty do vërtetohet që dy kandidatet fituese me mua, vitin e kaluar kjo dekane i ka miratuar si pedagoge të jashtme dhe këtë vit jo, pavarësisht që mesatarja e bachelorit e tyre është e njëjtë si vitin e kaluar dhe rregullat e punësimit janë të njëjta si vitin e kaluar.

Dekania citon që vendimin e ka kaluar për rishqyrtim të komisioni ad-hoc së bashku me urdhrin për zbatimin e rregullores së punësimit (i cili nuk është urdhër zbatimi por urdhër shfuqizimi). A ka ndonjë dokument zyrtar që vërteton përcjelljen për rishqyrtim të vendimit të Komisionit Ad-Hoc te ky komision? Ku vërtetohet? Nëse në fillim të kthimit të përgjigjet Dekania shprehet që thirrja e parë për aplikim për pedagog të jashtëm nuk është përcjellë te Fakulteti Ekonomik, si ka mundësi që është zhvilluar gjithë kjo procedurë për thirrjen e parë?

Dekania shprehet që vendimin e ka kaluar për rishqyrtim te komisioni me urdhër zbatimin e rregullores dhe në këtë Urdhër me nr prot 1299, datë 21.10.2025 (Aneksi 3 i kthimit të përgjigjes së dekanes) thuhet “Urdhëroj shfuqizimin e komisionit Ad-Hoc nr. 46, të datës 14.10.2025 për moszbatim të rregullores së punësimit...”, duke rënë ndesh fjalëve të saj që komisioni është mbledhur më datë 15.10.2025 për vlerësimin e kandidatëve dhe duke rënë ndesh me fjalët e më sipër përmendura nga dekania që **Shkeljet e konstatuara kanë qenë për të gjithë aplikantët se mesatarja ka qenë më e ulët... pasi në vendim thotë për moszbatim të rregullores së punësimit pa përmendur se çfarë dhe prandaj kërkoj komunikimit me email a shkresa mes dekanes dhe komisionit Ad-Hoc (nëse Dekania nuk i vë në dispozicion, mund të kërkohen nga komisioni).**

### **Pika 3:**

Dekania sërish bie në kontradiktë me çfarë shprehet e citon. Ajo shkruan “**Komisioni Ad-Hoc mbledhet për të vlerësuar kandidatet paraprake më datë 15.10.2025**”, ndërkohë që komisioni është mbledhur me datë 14.10.2025 pasi deklarohet dhe te vendimi i komisionit Ad-Hoc dhe po këtë datë ka dorëzuar vendimin për fituesit te dekania, vendim nr. 46, datë 14.10.2025 (Aneks 1 i kthimit të përgjigjes së dekanes). Komisioni mund ta vërtetojë këtë fakt. Dekania shprehet që **sistemi është hapur sërish më datë 14.10.2025** gjë e cila nuk vërtetohet nga emaili i IT pasi është pa datë dhe ka vetëm datën se kur mbyllet aplikimi (Aneksi 9 i kthimit të përgjigjes së dekanes). Dhe në vazhdim dekania sërish thotë që “**ka patur aplikantë të rinj që kishin sjellë dosjet për vlerësim dhe këto dosje janë tërhequr nga shefja e departamentit të Turizmit**”. Sërish dekania me ose pa dije, ngatërron dy procedurat e aplikimit. Në procedurën e parë janë dërguar emrat e aplikantëve nga dekania te Departamenti dhe është bërë vlerësimi i dosjeve të tyre dhe ka dal një vendim i komisionit Ad-Hoc. Por dorëzimi i dosjeve për aplikimin e dytë (që unë them që data e hapjes se aplikimit të dytë është më datë 15.10.2025), aplikantët janë njoftuar me email më datë 21.10.2025 (të cilin unë jua kam përcjellë), ku thuhet që dosjet të dorëzohen brenda datës 27 tetor 2025, pra afro 2 javë pasi ka dal vendimi i komisionit Ad-Hoc për procedurën e parë. Dhe Dekania sërish përcjell informacion të gabuar dhe fake, pasi nuk ka pasur dosje të dorëzuara e të tërhequra nga shefja e departamentit për llogari te aplikimit (procedurës së dytë) më datë 14.10.2025.

Në vendimin e komisionit Ad-Hoc të procedurës së dytë më datë 31.10.2025, thuhet “në kushtet e mungesës së informacionit për hapjen, rihapjen dhe mbylljen e sistemit të aplikimit on-line nga Rektorati duke u bazuar vetëm tek emaillet e Dekanes së FE, Prof. E. B. (bashkëngjitur këtij vendimi, u mblodh Komisioni Ad-Hoc” që dmth se Komisioni Ad-Hoc nuk ka qenë në dijeni dhe Dekania nuk e ka bashkëlidhur të plotë vendimin e komisionit Ad-Hoc pasi ka shkëputur emaillet që kanë qenë të bashkëlidhura me vendimin (Aneksi 4 i kthimit të përgjigjes së dekanes).

### **Pika 4 dhe 5:**

Sipas nenit 19 pika 2 e 3 si dhe nenit 22 të rregullores së punësimit të UNISHK, theksohet se procedura e ankimimit realizohet para miratimit përfundimtar të vendimit nga Rektori (cituat më sipër), e jo pas tij siç ka përmendur dekania.

**Neni 19: Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve**

Pas renditjes së konkurrentëve, komisioni ad-hoc harton vendimin me fituesit dhe e përcjell për miratim paraprak te dekani përkatës, i cili e përcjell te Rektori për miratim përfundimtar. Konkurentët njoftohen nga kryetari i komisionit ad-hoc.

**Neni 22: Akt-marrëveshja**

Pas procesit të ankimimit përgjegjësi i njësisë bazë/departamentit lidh akt-marrëveshjen për ngarkesën mësimore dhe afatin e punësimit. Akt-marrëveshja miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekanit.

Akt-marrëveshja duhet shogëruar me dokumentet e kërkuara në njoftimin përkatës.

Dosjet e kandidatëve fitues së bashku me akt-marrëveshjen dërgohen nga drejtuesi i njësisë bazë pranë Sektorit të Burimeve njerëzore të USH-së, së bashku me një kopje të vendimit të komisionit të miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani.

**Një kopje e vendimit të komisionit të miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani dërgohet edhe te Rektori.**

Dekania e ka përcjellë vendimin për miratim përfundimtar te Rektori më datë 5.11.2025 (siç ajo citon vetë) ndërkohë që unë si konkandidate jo fituese jam njoftuar me email më datë 4.11.2025 (email që jua kam përcjellë dhe ju). Këtu mendoj që është shkelur procedura ligjore dhe ka një mos transparencë të theksuar, kam bërë ankimim sipas rregullores së punësimit te UNISHK me datë 5.11.2025 dhe akoma nuk kam marr përgjigje.

Dekania sërish bie në kontradiktë me atë çfarë shpreh dhe me atë çfarë përmbajnë dokumentet që ajo ka dërguar. Ajo shprehet që **ka përcjellë vendimin e komisionit Ad-Hoc te rektori më datë 5.11.2025**, ndërkohë që ky vendim është përcjell te rektori më datë 3.11.2025 (Aneksi 8 i kthimit të përgjigjes së dekanes), duke shkelur sërish të drejtën time për ankimim, pasi unë jam njoftuar për jo fituese më datë 4.11.2025 (Aneksi 10 i kthimit të përgjigjes së dekanes) si dhe duke dhënë informacion zyrtar kontradiktor.

Në përputhje me **Ligjin Nr. 44/2015 "Për Procedurat Administrative"**, në veçanti me nenet që rregullojnë ankimin administrativ, është e qartë se procedurat e ankimit duhet të mbyllen **para miratimit përfundimtar të një akti administrativ**. Ky është një parim i rëndësishëm që siguron transparencën dhe drejtësinë në proceset administrative.

**Neni 128**, në seksionin për mjetet ligjore administrative, përcakton të drejtën e çdo palë për të ushtruar **ankim administrativ** ndaj një akti administrativ, nëse ndihen të dëmtuar nga ai akt. Ky nen e bën të qartë se çdo akt administrativ mund të ankimohet për shkak të **paligjshmërisë**, dhe palët që ndihen të cenuar nga një vendim mund të kërkojnë një shqyrtim të tij.

Në përputhje me këtë, **Neni 133** specifikon që **ankimi administrativ ndaj aktit administrativ** ka një efekt pezullues, duke ndaluar ekzekutimin e aktit administrativ deri në marrjen e një vendimi përfundimtar lidhur me ankimin. Kjo nënkupton se, përderisa ka një ankim të paraqitur, **vendimi përfundimtar** për miratimin e aktit nuk mund të zbatohet, përveçse në disa raste të veçanta të përcaktuara nga ligji.

Në këtë rast, nëse te Rektori është dërguar për miratim ose është miratuar vendimi përfundimtar për procedurën e dytë pa përfunduar procedura e ankimit, kjo shkel të drejtat e mia dhe parimet e përshkruara në ligj, duke u bërë një **shkelje të procedurës administrative**. E drejta për të ankimuar duhet të jetë përpara miratimit përfundimtar, dhe akti i Rektorit, si një akt administrativ përfundimtar, **duhet të mbetet i pezulluar** deri në përfundimin e shqyrtimit të ankesës (dhe jo siç thotë Dekania që pas miratimit përfundimtar njoftohen kandidatët që nuk kanë fituar dhe bëhet procesi i ankimit) .

### **Argumentet ligjore për shkeljen:**

**Pezullimi i ekzekutimit të aktit administrativ:** Sipas Neni 133, ankimi administrativ pezullon ekzekutimin e aktit deri në marrjen e vendimit përfundimtar për ankimin. Kjo do të thotë që, përderisa ka një ankim të papërfunduar, vendimi përfundimtar i Rektorit nuk mund të implementohet.

**Shkelja e procedurës ligjore të ankimit:** Neni 130 e thekson qartë se ankimi mund të bëhet ndaj një akti administrativ ose ndaj mosveprimit të organit për nxjerrjen e aktit në afatin e parashikuar. Çdo veprim procedural gjatë procedurës administrative, përfshirë miratimin e vendimeve përfundimtare, mund të ankimohet në përputhje me rregullat e përcaktuara.

**Kushtet për pranimin e ankimit dhe efektet e tij:** Sipas Neni 135 të Ligjit për Procedurat Administrative, ankimi është i pranueshëm vetëm kur është i paraqitur në kohën e duhur dhe i përmbush kërkesat ligjore, duke përfshirë pezullimin e efektit të aktit administrativ gjatë periudhës së shqyrtimit të ankimit. Miratimi përfundimtar i vendimit nga Rektori pa përfunduar procedura e ankimit përbën një shkelje të kësaj dispozite.

**Legjitimiteti për të ushtruar mjetet ligjore administrative:** Sipas Neni 128, çdo palë ka të drejtë të ushtrojë ankim administrativ ndaj aktit administrativ dhe, për rrjedhojë, ky mjet ligjor duhet të shqyrtohet dhe të respektohet para miratimit përfundimtar të aktit. Nëse procesi i ankimit është ende në zhvillim dhe nuk ka përfunduar, akti i miratimit përfundimtar është në kundërshtim me ligjin dhe mund të konsiderohet i paligjshëm.

Dekania me dije apo pa dije, në mos njohje të rregullores së punësimit të UNISHK ose duke mos e kuptuar mirë këtë rregullore (nuk di se çfarë emri ti vë), thotë që pasi përfundon procedura e miratimit te rektori që ajo shënon datën 5.11.2025 realizohet njoftimi i kandidateve me email dhe më pas ata kanë të drejtë ankimi. Mua më ka ardhur njoftim me email më datë 4.11.2025 para miratimit te rektori, dmth procesi i ankimit sipas dekanes bëhet para apo pas miratimit te rektori???????

Në shkresën tuaj (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi), nr prot 1479, datë 30.10.2025 “Njoftim dhe kërkesë për informacioni”, ju keni kërkuar Informacion nëse gjatë viteve 2024-2025 janë zhvilluar procedura të tjera konkurrimi për pedagogë të jashtëm në FE dhe nëse po, të vihen në dispozicion dokumentacioni i plotë i procedurave respektive të zhvilluara (Kopje të dosjeve të aplikantëve, kritereve të punësimit etj). Kjo kërkesë nuk është plotësuar nga dekania e FE të UNISHK dhe nisur nga kjo dhe për të mbështetur parashtrimet e mia kërkoj (brenda mundësive) verifikimin e dokumenteve:

**1. Komunikimet zyrtare mes Dekanit së Fakultetit Ekonomik dhe Komisioneve Ad-Hoc të të tre Departamenteve**

*Emaillet, shkresat dhe notat që janë shkëmbyer midis **Dekanes** dhe **Komisioneve Ad-Hoc** të tre departamenteve të Fakultetit Ekonomik për procedurat e punësimit të pedagogëve të jashtëm për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

*Dokumentet që konfirmojnë marrjen dhe përcjelljen e listës së aplikantëve dhe dosjeve për shqyrtim nga komisionet ad-hoc të të tre departamenteve për procedurat e punësimit të pedagogëve të jashtëm për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

## **2. Vendimet e Komisioneve Ad-Hoc për Procedurat e Punësimit**

*Vendimet e Komisioneve Ad-Hoc të të tre departamenteve për përzgjedhjen e kandidatëve për pozitat e pedagogëve të jashtëm për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026, duke përfshirë renditjen dhe vlerësimin e kandidatëve. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

*Aktet e miratimit të vendimeve nga Dekani dhe Rektori për përzgjedhjen e kandidatëve, përfshirë çdo akt miratimi dhe çdo vendim për ndryshim ose shfuqizim të këtyre vendimeve të të tre departamenteve, për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

## **3. Dokumente të Komisioneve Ad-Hoc**

*Vendimet e miratimit të anëtarëve të komisioneve Ad-Hoc të tre Departamenteve nga Dekania e FE për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026.*

*Dokumentet e vlerësimit të performancës akademike dhe profesionale të kandidatëve, përfshirë kriteret e pikëzimit të përdorura për çdo kandidat, për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 për të tre departamentet. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

## **4. Korrespondenca për Procedurat e Aplikimit dhe Ankimit**

*Korrespondenca zyrtare që ka të bëjë me hapjen dhe mbylljen e procedurës së aplikimit, duke përfshirë datat e shpalljes së thirrjes për aplikim dhe çdo njoftim që është dërguar nëpërmjet emailit. për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 për të tre departamentet. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

*Njoftimi për kandidatët që nuk janë shpallur fitues dhe dokumentet që vërtetojnë njoftimin dhe të drejtën e tyre për ankim për të dy procedurat.*

## **5. Dokumentet për Vlerësimin e Kandidatëve**

*Dosjet e aplikantëve fitues, që përfshijnë të gjitha dokumentet e dorëzuara gjatë procesit të aplikimit, përfshirë CV, dokumente akademike dhe prova të tjerë për vlerësimin e tyre. për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 për të tre departamentet. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

*Dokumentet që mbështesin vlerësimin e dosjeve nga komisionet ad-hoc, përfshirë vlerësimin dhe pikëzimin për secilin kandidat. për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 për të tre departamentet. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

## **6. Dokumente për Urdhrat e Dekanit dhe Rektorit**

*Urdhrat e Dekanit dhe Rektorit për hapjen e procedurave të aplikimit dhe për miratimin e vendimeve të komisioneve ad-hoc. për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 për të tre departamentet. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).*

Çdo urdhër ose vendim për shfuqizimin e procedurave të punësimit dhe çdo justifikim për shkak të shkelleve të procedurës. për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 për të tre departamentet. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).

#### **7. Dokumente për Miratimin e Vendimeve nga Komisionet Ad-Hoc**

Kopje e vendimeve të Komisioneve Ad-Hoc që janë dërguar për miratim te Dekani dhe Rektori. për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 për të tre departamentet. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).

Dokumente që verifikojnë kalimin e vendimeve te Rektori, përfshirë çdo akt miratimi të vendimeve përfundimtare të rekrutimit. për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026 për të tre departamentet. (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).

#### **8. Dokumentet që Mbështesin Kërkesën për Uljen e Mesatares**

Vendimet e Komisionit Ad-Hoc për uljen e mesatares për ata kandidatë që nuk e kanë përmbushur kriterin e mesataren e kërkuar për të tre departamentet (siç është përmendur për Departamentin e Turizmit) ose kritere të veçanta dhe kufij më të lartë apo më të ulët në varësi të specifikës së tyre, rast pas rasti për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026, (për vitin 2025-2026 për të dy procedurat).

Kërkoj gjithashtu të vihet në dispozicion për verifikim Vendimi i cituar ne anekse por që nuk është i bashkëlidhur kthimit të përgjigjes: Vendimi nr 42 date 22/09/2025, nr prot 1024 “Mbi aprovimin e kriterit per staf akademik me kohe te pjesshme”

#### **Shtesë:**

Unë kam marr info për vendimin e komisionit Ad-Hoc për procedurën e parë dhe për vendimin e shfuqizimit të tij nga Dekania vetëm në mënyrë informale. (Zyrtarisht për to u vura në dijeni vetëm nga ju në përcjelljen e kthimit të përgjigjes së dekanes). Duke patur parasysh këtë, me datë 22.10.2025 (pasi më erdhi emaili për dorëzim dosjeje për procedurën e dytë më datë 21.10.2025) i dërgoj dekanes një kërkesë për Informacion zyrtar për statusin e aplikimit tim të parë dhe me datë 3.11.2025 (3 ditë pas vendimit të komisionit Ad-Hoc për procedurën e dytë), Dekania më sjell përgjigje zyrtare që nuk kishte asnjë lidhje me kërkesën time. Të dyja këto jua kam forward dhe ju.

Përgjigja e Dekanes nuk përmbush kërkesën time, pasi ajo fokusohet në disa aspekte që nuk janë kërkuar në mënyrë specifike në kërkesën time:

#### **Përgjigje jashtë kërkesës për informacionin konkret mbi statusin e aplikimit tim:**

Unë kam kërkuar informacion të drejtpërdrejtë lidhur me statusin e aplikimit tim të parë dhe se pse nuk kam marrë asnjë njoftim zyrtar për procedurën e mëparshme (pra të parën). Ju kërkuat të dini nëse procedura është përfunduar apo jo dhe arsyetimin ligjor për hapjen e një konkursi të dytë pa njoftuar aplikuesit e procedurës së mëparshme. Përgjigja e Dekanes nuk adreson këtë çështje të veçantë, por është fokusuar më shumë tek detyrat e Dekanit sipas Statutit dhe procedura të përgjithshme për hapjen e aplikimeve.

#### **Mungesa e sqarimit për hapjen e konkursit të dytë:**

Një nga kërkesat e mia ishte që të sqarohesha zyrtarisht për hapjen e konkursit të dytë dhe mungesën e njoftimit zyrtar për aplikimin e parë. Dekania ka përmendur vetëm përgjegjësinë e saj për përcjelljen e aplikimeve tek departamentet përkatëse dhe ka përmendur që hapja e sistemit të aplikimit online është kompetencë e titullarit të Universitetit. Kjo përgjigje nuk është në përputhje

me kërkesën time, pasi nuk jep asnjë arsytim të qartë ligjor për pse nuk kam marrë asnjë informacion për aplikimin tim të parë dhe si u bë hapja e një konkursi të dytë pa njoftimin e kandidateve aplikant në procedurën e parë.

**Mungesa e sqarimit për të drejtat e mia të informimit dhe transparencës:**

Në kërkesën time kam theksuar parimet e transparencës dhe të drejtës për informacion, duke kërkuar që të vihen në dispozicion shkrimet dhe proceset administrative të përdorura për të vlerësuar aplikimin tim dhe për të informuar aplikantët. Dekania nuk ka dhënë asnjë informacion të detajuar mbi procesin e vlerësimit të aplikimit tim dhe si janë trajtuar aplikimet e tjera. Ajo ka përmendur përgjegjësitë e saj të përgjithshme pa theksuar dokumentacionin dhe komunikimet e brendshme që lidhen me aplikimin tim dhe të drejtat tuaja për transparencë.

**Përgjigje që mbështetet vetëm në përgjegjësitë e Dekanit dhe nuk sqarohen detajet e procedurës:**

Dekania ka përmendur përgjegjësitë e saj ligjore për të shfuqizuar vendimet e përgjegjësve të departamenteve, duke u mbështetur në nenet e Statutit, por kjo është jashtë kontekstit të kërkesës sime, e cila ka lidhje me kërkesën për sqarime për procedurën e aplikimit tim të parë dhe statusin e tij. Përgjigja e saj është e përgjithshme dhe nuk adreson veprimet specifike të kërkuara në kërkesën tuaj.

Arsyeja që pse nuk u vura në dijeni për të gjithë këtë procedurë të parë dhe mos vënia në dijeni për vendimet e procedurës së parë, më bën të mendoj që faktet mund të fshiheshin dhe që ka një shkelle flagrante të bazës ligjore të rregullores së punësimit, të Ligjit për Procedurat Administrative, të Ligjit për të drejtën e informimit, të Ligjit për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Nuk e kuptoj pse Dekania nuk më vuri në dijeni, ose të më përcillte një informacion zyrtar për procedurën e parë në kërkesën time të datës 22.10.2025, por unë vihem në dijeni vetëm tani”.

3. Në vijim, me e-mail-in datë 17.11.2025 dhe me shkresën<sup>7</sup> nr. 1567 prot., datë 19.11.2025, Fakulteti i Ekonomik Shkodër vuri në dispozicion të Komisionerit vendimin e dekanit për konkursin për pedagog të jashtëm Departamenti Turizëm.
4. Sakaq, Komisioneri përmes e-mail-it datë 18.11.2025, i përcolli ankueses përgjigjen dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e Fakultetit Ekonomik Shkodër.
5. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nenin 40, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)<sup>8</sup>”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 85 prot., datë 12.01.2026, vendosi të realizojë një seancë dëgjimore dhe ftoi palët në proces të merrnin pjesë për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre.

<sup>7</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1479/4 prot., datë 21.11.2025.

<sup>8</sup> <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

Në përgjigje sa më sipër, me e-mail-in datë 14.01.2026, E. B., me detyrë Dekane e Fakultetit të Ekonomisë, Shkodër, njoftoi Komisionerin dhe kërkoi që seanca dëgjimore të realizohet në datën 28.01.2026, pasi për arsye objektive nuk mund të jetë pjesë e saj në datën e njoftuar (27.01.2026) me shkresën nr. 85 prot., datë 12.01.2026.

6. Në këto kushte, pas konsultimit me palët në proces, Komisioneri me shkresën nr. 85/1 prot., datë 16.01.2026, njoftoi sërish palët për realizimin e seancës më datë 28.01.2026.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 28.01.2026, me pjesëmarrjen e palës ankuese, E. L. dhe subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa Dekanes së Fakultetit të Ekonomisë, Shkodër, znj. E. B.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan parashtresave me shkrim të depozituara paraprakisht pranë Komisionerit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, por edhe përmes e-mail-it datë 28.01.2026, Komisioneri, kërkoi nga ana e E. B. të vërë në dispozicion informacionin si më poshtë:

- Kopje të korrespondencës së mbajtur me Rektoratit sa i përket procedurave të konkurrimit për pedagog të jashtëm në Departamentin e Turizmit.
- A i është drejtuar Rektoratit me kërkesë me shkrim për shpalljen e vendeve vakante për pedagog të jashtëm për vitet akademike 2024-2025 dhe 2025-2026. Nëse po, kopje të tyre.
- Kopje e kërkesës së Komisionit AD-Hoc për uljen e notës mesatare për shpalljen e vendeve vakante për pedagog të jashtëm, për procedurën e konkurrimit ku ka marrë pjesë E. L..
- Kopje të vendimeve nr. 40 dhe nr. 42, datë 22.09.2025 të cituara në Vendimin Nr. 46, datë 14.10.2025 të Komisionit Ad-Hoc.
- Kopje të shpalljeve të procedurave të konkurrimit për pedagog të jashtëm në Departamentin e Turizmit për vitin akademik 2024-2025 dhe 2025-2026.
- Kopje e procedurës së plotë të konkurrimit për pedagog të jashtëm me gradën Doktor në Departamentin e Turizmit, ku është shpallur fituese A. Z.
- Të përcillen 2 (dy) kopjet e Rregulloreve të Punësimit në Universitetin e Shkodrës të ndryshuara gjatë vitit 2025.

7. Në vijim të seancës dëgjimore, Fakulteti Ekonomik Shkodër, depozitoi pranë Komisionerit shkresën nr. 259 prot., datë 18.02.2026, ku ndër të tjera parashtron:

*“...1. Nga ana e Fakultetit Ekonomik nuk është kërkuar hapja e konkursit për vitin akademik 2025-2026 dhe kjo procedurë është zhvilluar nga rektorati (Rektori dhe Burimet Njerëzore). Në këtë rast nuk është njoftuar dekani për hapjen e procedurës së aplikimit.*

*Herën e dytë, kur është rihapur aplikimi, ka ardhur email nëpërmjet IT nga shkresa e burimeve njerëzore, përcjellë nga IT e fakultetit, për shtyrjen e afatit të aplikimeve, sipas aneksit të dërguar më parë (ANEKS 10).*

Deri në mbylljen e regjistrimeve në programin master, fakulteti nuk mund të përcjellë një kërkesë për hapje vendesh, për shkak se nuk është e sigurt nëse do të plotësohet numri minimal për hapjen e programit.

Pra, hapja e aplikimeve nuk është realizuar nga ana e fakultetit por nga ana e rektoratit për të 2 rastet. Në rastin e hapjes së vendit për lëndët e mbetura të zbuluara në master, është dërguar propozimi për hapjen e vendit dhe propozimi për uljen e mesatares.

Vetëm pas miratimit nga ana e rektorit, është realizuar procedura e hapjes së sistemit nga rektorati - shpallja e njoftimit – dhe dërgimi i aplikantëve tek dekani i fakultetit. Dekani në këtë rast vetëm përcjellë aplikimet tek shefi i departamentit.

2. Dr. A. Z. është punësuar për herë të parë në vitin akademik 2021–2022 duke u bazuar në Nenin 10, pika 1 të rregullores ë vjetër të punësimit të miratuar në vitin 2009 sipas të cilës kriteret për pedagog të jashtëm nuk kanë qenë skualifikuese (aneks 11a & b & c & d).

Pra, në këtë rast, mosplotësimi i një kriteri nuk përjashtonte kandidatin nga gara.

Neni 10, pika 1, “Kritere për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme”, ku shkruhet shprehimisht “Për personelin akademik me kohë të pjesshme zbatohen kriteret e mësipërme **nuk kanë karakter përjashtues** (ndryshe nga rregullorja e vitit 2025)”.

Vitet pasardhëse është kaluar në procedurë rinovimi automatik për kandidatët që kanë qenë të aktivizuar më parë, duke **realizuar vetëm një vlerësim performance** nga ana e departamentit sipas rregullores së re të vitit 2022 (Rregullorja e punësimit është miratuar në vitin akademik 2022-2023 dhe ka parashikuar rinovim automatik për personat e punësuar pranë departamenteve)...

Gjithsesi, këto procedura janë kryer përpara Vitit 2024, në të cilin jam bërë Dekane e FE-së (Shtator 2024).

3. Për vitin 2025-2026, Dr. A. Z. është punësuar vetëm pasi ka përfunduar procedura e punësimit për **pedagogët e jashtëm** dhe është verifikuar se ata nuk mund të japin mësim në programin master sipas legjislacionit në fuqi. Kërkesa për punësim me gradën doktor dhe për uljen e mesatares ka ardhur nga departamenti i turizmit me shkresën nr. 1396, datë 03.11.2025.

Departamenti ka paraqitur kërkesën për ngarkesën e mbetur të pambuluar, së bashku me propozimin për uljen e kriterit të mesatares.

Ky kriter është miratuar nga unë dhe është përcjellë për miratim përfundimtar tek Rektori, sipas rregullores në fuqi (Aneks 2) bazuar në rregulloren e punësimit në USH, neni 15, pika 9 “Njësia kryesore, me miratim të Rektorit të USH-së, mund të vendosi kritere të veçanta dhe kufij më të lartë apo më të ulët në varësi të specifikës së tyre, rast pas rasti. Ata kanë detyrimin t'i bëjnë të njohura në njoftimin për vendin vakant”.

Në këtë rast, është e detyrueshme që kandidati të ketë kualifikimin përkatës për të dhënë mësim në nivel master (minimumi duhet të ketë kualifikimin e ciklit pasardhës – doktoraturë).

Në momentin e miratimit nga ana e Rektorit, është hapur aplikimi nga Rektorati sipas afateve të përcaktuara prej tyre. Pas përfundimit të procedurës, aplikimet janë përcjellë nga Burimet Njerëzore, dhe Dekani i ka përcjellë tek shefja e departamentit.

Pasi komisioni është mbledhur, ka shpallur fituese kandidaten A. Z., dhe kjo procedurë është miratuar nga Dekani dhe nga Rektori (miratuesi përfundimtar sipas rregullores).

4. Aplikantja pretendon diskriminim për shkak të pakënaqësisë lidhur me kandidimin në zgjedhje, por unë kam mbajtur **gjithmonë qëndrim korrekt dhe me respekt**. Bashkëngjitur **gjeni edhe mesazhet (SMS) e dërguara nga kandidatja në numrin tim**, si dhe përgjigjen që i kam dhënë. Siç mund të verifikohet, nuk ka pasur asnjë komunikim me tone negative apo konfliktuale (nuk e kam pasur numrin e saj të telefonit por kam kthyer përgjigje duke respektuar kandidaten). (Aneks 12 a & b & c).

5. Kopje të korrespondencës midis Fakultetit Ekonomik dhe Rektoratit nuk ka për hapjen e vendeve vakante për asistent lektorët part time, pasi Rregullorja e Punësimit parashikon që kjo është kompetencë e Rektoratit.

6. Vendimet e Dekanit janë ankimuar nga aplikuesja dhe tek rektori i Ush-së, i cili ka të drejtën ligjore dhe statuale për shfuqizimin e vendimeve të dekanit”.

8. Përmes e-mail-it datë 18.02.2026, Komisioneri i përcolli ankueses, përgjigjen e vënë në dispozicion nga ana e E. B. Sa më sipër, ankuesja përmes e-mail-it datë 20.02.2026, vendosi në dispozicion parashtrimet e saj pranë Komisionerit, të cilat në thelb janë depozituar edhe më parë gjatë korrespondencës së mbajtur.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Bazuar në tërësinë e akteve dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se ankuesja është vënë në dijeni sa i përket thirrjes së publikuar nga Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për pedagog të jashtëm në Departamentin e Turizmit të Fakultetit Ekonomik. Sakaq, më datë 26.09.2025, ajo ka aplikuar on-line në faqen web të Universitetit, për pozicionin e pedagoges së jashtme në Fakultetin Ekonomik.

Pas aplikimit të kryer on-line, ankuesja është paraqitur pranë Departamentit të Turizmit, të Fakultetit Ekonomik, më datë 10.10.2025, ku ka depozituar dosjen si aplikuese për pedagog të jashtëm pranë këtij departamenti. Lidhur me këtë proces, rezulton të jetë nënshkruar edhe procesverbali përkatës nga ana e saj dhe e Përgjegjëses së Njësisë Bazë Turizëm, A. T.

Pas këtij momenti, komisioni Ad-Hoc, i Departamentit të Turizmit, kishte marrë vendimin Nr. 46, datë 14.10.2025, ishin për zgjedhur kandidatët si më poshtë:

- Dr. A. Z.,
- E. L., Msc,
- S. H., Msc.

Në vijim, përmes Urdhrit Nr. 9, datë 21.10.2025, Dekania e Fakultetit Ekonomik, E. B., ka shfuqizuar vendimin e Komisionit Ad-hoc, të Departamentit Turizëm Nr. 46, datë 14.10.2025 “Për

përzgjedhjen e stafit akademik me kohë të pjesshme”, për moszbatim të Rregullores së Punësimit në USH.

Sipas informacionit të administruar nga ana e Dekanes së Fakultetit Ekonomik, rezulton se ajo nuk ka patur dijeni lidhur me publikimin e thirrjes nga Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, për pedagog të jashtëm në Departamentin e Turizmit të Fakultetit Ekonomik. Nga sa E. B. ka parashtruar, publikimi i thirrjes është bërë nga ana e Universitetit të Shkodrës dhe ajo nuk është vënë në dijeni as lidhur me procedurat e ndjekura nga Departamenti i Turizmit. Kjo ka qenë një ndër arsyet pse ajo ka urdhëruar shfuqizimin e vendimit të Komisionit Ad-hoc të Departamentit të Turizmit Nr. 46, datë 14.10.2025.

Statuti i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në nenin 32, pika 6, parashikon se: “Dekani ka këto detyra dhe kompetenca:

- a) dekani i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij.
- b) paraqet në rektorat dhe në Senatin Akademik të USH-së propozime për probleme të ndryshme të dekanatit;
- c) informon dekanatin për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fakultet;
- d) miraton planin kalendarik të procesit mësimor për çdo vit akademik në bazë të udhëzimeve të rektoratit dhe të strukturës mësimore vjetore;
- e) ndjek plotësimin korrekt të dokumentacionit shkollor;
- f) i propozon dekanatit me kërkesë te departamentit hapjen, mbylljen, reformimin e programeve të studimit, të departamenteve apo të njësive të veçanta në fakultet;
- g) i propozon dekanatit hapjen e qendrave kërkimore dhe të zhvillimit, të programeve të ndryshme të studimeve, ofrimin e shërbimeve të ndryshme për të tretët, pjesëmarrjen në projekte brenda apo jashtë vendit;
- h) organizon dhe mbikëqyr cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, të zbatimit të kontratave të punës dhe të çdo detyrimi tjetër të marrë përsipër nga departamentet apo personeli i fakultetit.
- i) ka të drejtë të shfuqizojë vendimet e përgjegjësit të departamentit kur ato bien ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, me këtë Statut, me rregulloret e USH-së dhe me vendimet e Senatit e të dekanatit;
- j) me autorizimin e Rektorit ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me fakultete e institucione homologe të vendit e të huaja;
- k) emëron përgjegjësit e zgjedhur të departamenteve;
- l) drejton dhe kontrollon konkurset e pranimit të punonjësve akademikë e joakademikë në fakultetin e tij;
- m) propozon masa administrative dhe disiplinore, sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore ndaj personelit deri në lirim nga detyra ndërsa ndaj studentëve deri në përjashtimin nga shkolla.”

Pra, sa më sipër dhe në zbatim të kompetencave të parashikuara në Statutin e Universitetit të Shkodrës, E. B. gjatë kontrollit të procedurës së konkursit të pranimit të punonjësve ka konstatuar se procesi ishte zhvilluar në shkelje të Rregullores së Universitetit të Shkodrës.

Rregullorja e Punësimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, rishikuar me Vendimin Nr. 162, datë 27.05.2025, në nenin 4, parashikon se:

*“1. Vendet e punës për personelin akademik, ndihmës akademik dhe atë administrativ fitohen me konkurs. Ato ruhen mbi bazën e kontratës së punës, duke respektuar parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, Kodit të Punës dhe Statutit të USH-së.*

*2. Punësimi në USH realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.*

*3. Konkursi për vendet e lira shpallet nga Rektori, sipas propozimit të strukturave përgjegjëse ku gjendet një vend i tillë”.*

Neni 15 “Kritere për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme”, i Rregullores së sipërcituar, përcakton ndër të tjera se: *“1. Kandidati duhet të jetë diplomuar në të gjitha ciklet e shkollimit në fushën përkatëse, në sistemin me kohë të plotë (për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet certifikata e njohjes nga Ministria përgjegjëse).*

*2. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk), i përket nivelit 6, (Bachelor, Program studimi i nivelit të parë) duhet të jetë jo më e ulët se 8.5, kurse nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurrohet duhet të jetë jo më e ulët se 9. Kandidati që konkurron duhet të jetë testuar domosdoshmërisht në fushën për të cilën pretendon të jetë mësimdhënës.*

*3. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk), i përket nivelit 7 (Master i shkencave, Master i arteve/Master i arteve të bukura/Program studimi i nivelit të dytë/Program studimi i integruar i ciklit të dytë/Program studimi 4- vjeçar (para hyrjes në fuqi të sistemit të Bolonjës) duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 dhe nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurrohet të jetë jo më e ulët se 9.*

*4. Të ketë mbaruar studimet që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk), i përket nivelit 8 (Doktoratë, Shkollë pasuniversitare studimesh të thelluara).*

*4.1 Përjashtohen nga kriteri i mesatares së cikleve paraardhëse kandidatët për personelin akademik me kohë të pjesshme, të kategorisë “Profesor”...”.*

Nga informacioni i administruar në Tabelën e Vlerësimit të mbajtur nga Komisioni AD-hoc, rezulton se kandidatet e shpallura fituese nga ky komision, rezultonin me mesatare të Bachelor-it, si më poshtë:

- Dr. A. Z., me notë mesatare 7.9;
- Msc. E. L., me mesatare 6.1;
- Msc. S. H., me mesatare 7.3.

Në këtë kuadër, Dekania e Fakultetit Ekonomik, ka konstatuar se në procedurën e hapur për vendet e lira për pedagog të jashtëm në Departamentin e Turizmit të Fakultetit Ekonomik, kandidatët nuk kanë plotësuar kriterin e mesatares së Bachelor-it (e cila duhet të jetë mbi 8.5, sipas nenit 15 pika 2, 3 dhe 4). Sakaq, mbështetur në kompetencat e parashikuara në nenin 32, pika 6/i, të Statutit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Dekania e Fakultetit Ekonomik ka shfuqizuar vendimin e Komisionit Ad-hoc.

Në vijim, kjo procedurë nuk është mbyllur apo anuluar, por rezulton se përmes e-mail-it të dërguar nga ana e Sektorit IT, është rihapur aplikimi on-line për kandidatët që dëshirojnë të angazhohen si pedagogë të jashtëm për vitin akademik 2025-2026. Sakaq, ankuesja ka dorëzuar sërish aplikimin e saj për pedagogë të jashtëm për vitin akademik 2025-2026, në Departamentin e Turizmit.

Neni 18 “Përzgjedhja e kandidatëve të personelit akademik me kohë të pjesshme”, i Rregullores së Punësimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, parashikon se:

*“1. Përzgjedhja e kandidatëve të personelit akademik me kohë të pjesshme bëhet nga njësia bazë/departamenti përkatës dhe monitorohet nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani i fakultetit përkatës.*

*2. Për përzgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve të personelit akademik me kohë të pjesshme, njësia bazë/departamenti krijon komisionin ad-hoc me 3 ose 5 anëtarë.*

*3. Komisioni propozohet nga përgjegjësi i njësisë bazë/departamentit dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekani i fakultetit përkatës. Kryetar i komisionit është drejtuesi i njësisë bazë/departamentit.*

*4. Komisioni ad-hoc rendit aplikantët sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore dhe me email bëhet njoftimi i secilit aplikant për përmbushjen ose jo të kriterëve të përcaktuara. Kopja e email-it të dërguar ruhet në departamentin përkatës dhe vendoset në dosjen e aplikantit.*

*5. Aplikantët fitues që kanë qenë pjesë e stafit akademik me kohë të pjesshme në vitin e kaluar akademik duhet të dorëzojnë vetëm dokumente për përditësimin e dosjes së tyre. Në dosje duhet të vendoset edhe vlerësimi me shkrim i departamentit për performancën e aplikantit”.*

Neni 19, “Procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve”, i Rregullores së USH, përcakton se:

*“1. Dosjet shqyrtohen nga komisioni ad-hoc. Komisioni rendit fituesit sipas radhës zbritëse, duke filluar nga konkurenti që rezulton me pikë më të larta, deri tek ai që ka pikët më të ulëta. Komisioni verifikon të dhënat e aplikantëve dhe skualifikon aplikantët që kanë deklaruar të dhëna jo të vërteta.*

*2. Renditja bazohet te sistemi i pikëzimit të detajuar në këtë rregullore. Komisioni ad-hoc vlerëson performancën akademike dhe profesionale të kandidatit. Pas renditjes së konkurrentëve, komisioni ad-hoc harton vendimin me fituesit dhe e përcjell për miratim paraprak te dekani përkatës, i cili e përcjell te Rektori për miratim përfundimtar.*

*3. Konkurentët njoftohen nga kryetari i komisionit ad-hoc.*

*4. Lista e kandidatëve fitues për pedagogë me kohë të pjesshme me gjeneralitetet përkatëse emër/mbiemër, shpallet në faqen zyrtare të USH-së, sipas afateve të përcaktuara nga komisioni”.*

Në zbatim të parashikimeve të rregullores së USH, pas dorëzimit të aplikimeve nga të gjithë kandidatët, Komisioni Ad-hoc, me Vendimin Nr. 49, datë 31.10.2025, ka shqyrtuar dosjet e aplikimeve në sistem dhe ka vendosur në përzgjedhjen e kandidatëve fitues, si më poshtë:

- E. K., Msc;
- A. F., Msc, aplikues i ri.

Mbështetur në tabelën e vlerësimit, bashkëngjitur Vendimit Nr. 49, datë 31.10.2025, të Komisionit Ad-hoc, rezulton se janë vlerësuar 7 (shtatë) kandidatura, ndër to edhe ankuesja. Nga analiza e informacionit të referuar në tabelë rezulton se:

- Kandidatja M. L., nuk është kualifikuar fituese për shkak se është jashtë specialitetit;
- Kandidati R. L., nuk është kualifikuar fitues për shkak se nuk plotëson mesataren e Bachelor-it;
- Kandidatja S. M., nuk është kualifikuar fituese për shkak se nuk plotëson mesataren e Bachelor-it;
- E. L. nuk është kualifikuar për shkak se nuk plotëson mesataren e Bachelor-it;
- Kandidatja F. M., nuk është kualifikuar fituese për shkak se është jashtë specialitetit.

Me shkresën nr. 1393 prot., datë 03.11.2025, Departamenti i Turizmit, i ka përcjell Dekanes së Fakultetit Ekonomik, listën e aplikuesve për pedagog të jashtëm dhe tabelën respektive të vlerësimit të tyre nga Komisioni Ad-hoc. Në vijim, me shkresën nr. 1395 prot., datë 03.11.2025, Fakulteti Ekonomik i ka përcjell Rektorit të Universitetit të Shkodrës, propozimet për miratim të pedagogëve të jashtëm për vitin akademik 2025-2026 për Departamentin e Turizmit.

Në përfundim të procedurës Kryetarja e Komisionit Ad-hoc, përmes e-mail-it datë 04.11.2025, ka njoftuar ankuesen se nga rezultatet e aplikimit për pedagog të jashtëm pranë Departamentit të Turizmit, Fakulteti i Ekonomisë, ajo nuk është shpallur fituese.

Bazuar në dispozitat dhe analizën e mësipërme, rezulton se, procedura e përzgjedhjes së personelit akademik me kohë të pjesshme, realizohet nga njësia bazë/departamenti dhe monitorohet nga njësia kryesore/dekani i fakultetit përkatës. Në rastin konkret procedura është realizuar nga Departamenti i Turizmit/njësia bazë nën monitorimin e Dekanit të Fakultetit Ekonomik. Rektori ka për detyrë që të nënshkruajë kontratat me pedagogët me kohë të pjesshme të cilët janë shpallur fitues nga njësia bazë.

Në përfundim të procedurës së vlerësimit dhe përzgjedhjes së realizuar nga komisioni i përzgjedhjes i ngritur pranë njësisë bazë/Departamentit të Turizmit, ankuesja nuk është përzgjedhur si kandidate fituese, pjesë e stafit akademik me kohë të pjesshme në vitin akademik 2025-2026. Në këtë mënyrë, ankuesja rezulton se nuk i plotëson dhe përmbush të gjitha kriteret për t'u punësuar si staf akademik me kohë të pjesshme pranë USH, Fakulteti Ekonomik, Departamenti i Turizmit.

Sa i përket pretendimeve për mungesë transparence dhe njoftimi lidhur me procedurat konkurrimit, Komisioneri vëren se:

Neni 21 “E drejta e ankimimit”, i Rregullores së USH-së, parashikon se:

“1. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë drejtuesit të njësisë kryesore/dekanit. Ankimimi duhet të paraqitet me shkrim brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e rezultatit.

2. Brenda 5 (pesë) ditëve Dekani shqyrton ankimimet dhe merr vendim. Vendimi i tij duhet të jetë i arsyetuar dhe është i formës së prerë.

3. Pas procesit të ankimimit përgjegjësi i njësisë bazë/departamentit lidh akt-marrëveshjen për ngarkesën mësimore dhe afatin e punësimit. Akt-marrëveshja miratohet nga drejtuesi i njësisë kryesore/dekanit”.

Nga informacioni i administruar, ankuesja më datë 22.10.2025, i është drejtuar Rektorit të Universitetit të Shkodrës dhe Drejtueses së Departamentit të Turizmit të Fakultetit Ekonomik, me kërkesë për informacion, duke i sqaruar ndër të tjera se: “...Aplikimi i parë elektronik në sistem është regjistruar më datë 26.09.2025. Gjatë periudhës 15-17 tetor 2025, është hapur sërish konkurs online për të njëjtin pozicion, dhe unë kam aplikuar përsëri. Duke marrë parasysh se nuk kam marrë asnjë njoftim zyrtar lidhur me statusin e aplikimit të parë, ju lutem të më njoftoni me shkrim dhe në mënyrë zyrtare për çfarë është bërë me procedurën e parë, a është përfunduar/regjistruar, nëse jo, përse nuk jam njoftuar për rezultatin dhe cili është arsyetimi ligjor për hapjen e konkursit të dytë pa informacion për aplikuesit e procedurës së mëparshme...”.

Pasi ankuesja është vënë në dijeni nga Kryetarja e Komisionit Ad-hoc, përmes e-mail-it datë 04.11.2025, lidhur me rezultatet e aplikimit për pedagog të jashtëm pranë Departamentit të Turizmit, Fakulteti i Ekonomisë, ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të Komisionit Ad-hoc të Departamenti të Turizmit, i cili nuk e ka shpallur fituese në procedurën e përzgjedhjes.

Sa më sipër, në përgjigje të ankesës së depozituar, Fakulteti Ekonomik, i është drejtuar ankueses me shkresën kthim përgjigje nr. 1478 prot., datë 12.11.2025, duke i sqaruar ndër të tjera se: “Në shkresën me Nr. 1417 Prot., datë 05.11.2025 dhe shkresës Nr. 1429 Prot., datë 06.11.2025, kandidatja për pedagoge me kohë të pjesshme E. L. ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të komisionit Ad-hoc, Departamenti i Turizmit, i cili nuk e ka shpallur fituese në procedurën përzgjedhjes.

Në vendimin përfundimtar të komisionit Ad-hoc nr. 49, datë 31.10.2025 (plotësuar më datë 03.11.2025), në tabelën e vlerësimit është përcaktuar se kandidatja E. L. nuk plotëson kriterin e mesatares (mesatare 6.1).

Pas shqyrtimi të dokumentacionit rezulton se në dosjen e kandidatës gjendet e depozituar diploma universitare që vërteton se studentja rezulton e diplomuar në Fakultetin Ekonomik, të cilën e ka filluar në vitin 1993 dhe e ka përfunduar në vitin 2005.

Nga verifikimi i diplomës rezulton se në këtë rast duhet zbatuar neni 15, pika 4 e Rregullores së Studimeve (neni 124, pika 2 e ligjit nr. 80/2015), sipas të cilës: “Nota mesatare e përgjithshme e studimit për diplomat e lëshuara nga Republika e Shqipërisë, të cilat janë ekuivalente me diplomat “Master i Shkencave” dhe që kanë zgjatur të paktën 4 vite akademike (8 semestra), deri në përshtatjen e studimeve sipas parimeve të Bolonjës, duhet të jetë jo më e ulët se 8.5; kurse nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurohet duhet të jetë jo më e ulët se 9”.

*Pas verifikimit të listës së notave, nota mesatare e diplomës është 6.1 dhe për këtë arsye nuk plotëson kriterin ligjor të përcaktuar në nenin 15, pika 4 të Rregullores të Studimeve.*

*Bazuar në këtë gjetje, konfirmohet se vendimi i marrë nga Komisioni Ad-hoc i Departamentit të Turizmit është plotësisht i bazuar në dispozitat e Rregullores së Punësimit.*

*Për këtë arsye, në vendimin nën cilësinë e dekanit me Nr. 22, datë 12.11.2025, me Nr. 1477 Prot., datë 12.11.2025, vendosa, të rrëzoj ankesat e paraqitura nga kandidatja E. L. pasi ajo nuk plotëson kriterin e mesatares të përcaktuar në nenin 15, pika 4 të Rregullores së Studimeve. Bazuar në nenin 21, pika 2 të Rregullores së Studimeve, ky vendim është i formës së prerë.”*

Në analizë për sa më sipër, rezulton se:

- Procedura e aplikimit për pedagog të jashtëm pranë Departamentit të Turizmit, Fakulteti i Ekonomisë, nuk është mbyllur me shfuqizimin e vendimit të Komisionit Ad-hoc të Departamentit të Turizmit Nr. 46, datë 14.10.2025 siç pretendohet nga ana e ankueses. Mbështetur në provat e administruara, ky urdhër ka të bëjë me shfuqizimin e vendimmarrjes së Komisionit Ad-hoc, për arsyet e sipërcituara në këtë vendim;
- Detyrimi i Dekanit të Fakultetit Ekonomik apo Kryetarit të Komisionit Ad-hoc, për të kthyer përgjigje, sipas akteve të sipërcituara, i lind në momentin pas renditjes së konkurrentëve dhe vendimmarrjes së komisionit. Në këtë kuptim, duke qenë se nuk ka patur një vendim përfundimtar për këtë proces, detyrimi për të kthyer përgjigje i ka lindur Dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe Kryetarit të Komisionit Ad-hoc, pas datës 03.11.2025;
- Mbështetur në nenin 21, të Rregullores sipërcituar, kandidatët jo fitues kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë drejtuesit të njësisë kryesore/dekanit me shkrim brenda 2 (dy) ditëve nga shpallja e rezultatit. Brenda 5 (pesë) ditëve Dekani shqyrton ankimimet dhe merr vendim. Vendimi i tij duhet të jetë i arsyetuar dhe është i formës së prerë. Përsa është analizuar, kjo procedurë është ndjekur e plotë dhe në kohë nga ana e Dekanit të Fakultetit Ekonomik.

Në përfundim, Komisioneri konstaton se, nga ana e Dekanes së Fakultetit Ekonomik, ndaj së cilës është depozituar ankesa, veprimet e ndërmarra sa i përket procedurës së ndjekur lidhur me konkursin për pedagogë të jashtëm në Departamentin e Turizmit, janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin e Universitetit të Shkodrës dhe Rregullores së Punësimit. Pretendimet e ankueses për shkelje ligjore në procesin e konkurrimit për pedagogë të jashtëm në Departamentin e Turizmit, nuk rezultuan të provuara. Nuk rezulton që ankuesja të jetë trajtuar në mënyrë të pafavorshme apo të pabarabartë nga ana e Dekanes së Fakultetit Ekonomik lidhur me procedurën e ankimuar pranë Komisionerit, pasi nga ana e saj është mbajtur i njëjti qëndrim për ankuesen dhe kandidatët e tjerë të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta

*e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Në nenin 12/1/a) dhe b) të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:*

*a) shpalljen e vendeve të lira të punës;*

*b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;..”.*

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara nuk rezultoi se ankuesja është vendosur në pozita të pabarabarta apo të pafavorshme nga ana e Dekanes së Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, sa i përket trajtimit të saj gjatë procedurave të konkurrimit për pedagogë të jashtëm pranë Departamentit të Turizmit, krahasuar me kandidatë të tjerë të cilët ndodhen në kushte të njëjta me të.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Dekanes së Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, lidhur me trajtimin të saj gjatë procedurave të konkurrimit për pedagogë të jashtëm pranë Departamentit të Turizmit.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm të tij, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses E. L., nga ana e Dekanes së Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjendja arsimore dhe çdo shkak tjetër<sup>9</sup>)  
(Fusha: Punësim)

---

<sup>9</sup> Ka referuar se shkak është bërë fakti që ajo ka qenë vëzhguese në zgjedhjet për organet drejtuese të Universitetit të Shkodrës, tek Fakulteti i Ekonomisë, i kandidatës e cila nuk është shpallur fituese për pozicionin e Dekanit të këtij fakulteti.